

— RAPORT MONITORIMI —

PERCEPTIMI I QYTETARËVE MBI KORRUPSIONIN NË SHQIPËRI

PRILL 2023

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

Tabela e përmbajtjes

Analiza e kontekstit	3
Metodologjia dhe të dhënat demografike	4
Analiza e gjetjeve kryesore	5
Perceptimi i qytetarëve për korrupsionin dhe përvoja me sjellje korruptive	5
Digjitalizimi i shërbimeve publike dhe korrupsioni	7
.....	8
Sektorët me nivelin më të lartë të perceptimit të korrupsionit (12 -20)	8
Sjelljet dhe qëndrimet ndaj aferave korruptive (24 25 26 27)	12
Efikasiteti i masave anti-korrupsion	14
Gjetjet Kryesore.....	15
Rekomandime.....	16

Analiza e kontekstit

Korrupsioni është një nga problemet më shqetësuese në Shqipëri dhe lufta ndaj këtij fenomeneni vijon të mbetet një nga kushtet kryesore për integrimin euro-atlantik të vendit. Shumë raporte dhe vlerësime të kryera nga organizata dhe institucione lokale dhe ndërkombëtare rreth perceptimit të qytetarëve dhe bizneseve mbi këtë fenomen, dëshmojnë në vijimësi për shkallën e gjerë të përhapjes së tij në sektorin publik. Në raportin e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të realizuar nga Transparency International për vitin 2022 Shqipëria renditet në vendin e 101 nga 180 vende në Botë për nivelin e korrupsionit, me vetëm 36 nga 100 pikë¹. Kjo renditje tregon një shkallë të lartë perceptimi të korrupsionit në Shqipëri, në krahasim me vendet e tjera të rajonit, konkretisht me Malin e Zi i cili renditet në vendin e 65 dhe Kosova në vendin e 84 nga 180 shtete. Një tjetër dokument shumë i rëndësishëm është raporti i Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2022, i cili e vlerëson korrupsionin si një nga shqetësimet më serioze dhe thekson rritjen e numrit të ndëshkimeve për zyrtarët e nivelit të lartë si prioritetin kryesor për të çrrenjosur kulturën e pandëshkueshmërisë në vend.²

Në kuadër të luftës kundër korrupsionit, qeveria shqiptare është në fazën e përgatitjes së një dokumenti të ri strategjik *“Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023-2030”*³. Strategjia e mëpashme Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020, u la në fuqi deri në vitin 2023, pa një analizë dhe rezultate konkrete mbi arritjet dhe mangësitë e saj. Një tjetër zhvillim në këtë fushë është organizimi i Konferencës e Parë Antikorrupsion, në qershor 2022. Në këtë konferencë, për 3 ditë rresht u mbledhën në sallën e Pallatit të Kongreseve mijëra punonjës të administratës publike, por përveç retorikës dhe fjalimeve politike nuk u prezantua asnjë analizë apo rezultat konkret.

Duke marrë shkas nga këto raporte, por edhe zhvillimet e fundit ku disa zyrtarë të lartë publikë kanë përfunduar nën praga me akuzën e korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës, organizata Qëndresa Qytetare për të dytin vit radhazi ka realizuar një hulumtim të opinionit publik për perceptimet dhe eksperiencat e qytetarëve mbi nivelin e korrupsionit në vend. Nëpërmjet këtij raporti, Qëndresa Qytetare synon të analizojë perceptimin dhe përvojën e vetë qytetarëve me raste të korrupsionit në sektorët e ndryshëm publikë, njohuritë mbi strukturat anti-korrupsion, qëndrimet e tyre, besueshmërinë e tyre tek institucionet publike dhe efikasitetin e masave të ndërmarra në këtë fushë.

¹ Corruption Perception Index, Transparency International 2022

<https://www.transparency.org/en/countries/albania>

² Comision Staff Working Document, Albania 2022 Report, faqe 22 <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>

³ Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023-2030 https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2022/08/DRAFT--KONCEPT-DOKUMENTI-STRATEGJIK-SNKK-2023-2030--8.8.2022_AL.pdf


Metodologjia dhe të dhënat demografike

Kjo analizë bazohet në të dhënat e gjeneruara nëpërmjet një pyetësi të shpërndarë online nëpërmjet rrjeteve sociale të organizatës Qëndresa Qytetare. Pyetësi përmban 29 pyetje të strukturuar që mundësojnë mbledhjen e të dhënave sasiore në mënyrë anonime.

Kampioni i përzgjedhur përmban 686 të anketuar, shtetas të Republikës së Shqipërisë mbi moshën 18 vjeç. Nëpërmet formave të sponsorizimit që mundësojnë rrjetet sociale, pyetësi është shpërndarë edhe në qytetarë që nuk janë ndjekës të organizatës, për të shmugur uniformitetin e opinionëve dhe përfaqësimin e vetëm një grupimi të qytetarëve që mbështesin punën e Qëndresa Qytetare në rrjete sociale. Ne konsiderojmë që ky është një kampion përfaqësues i popullatës dhe na mundëson t'i përgjithësojmë gjetjet e studimit tek e gjithë popullata si një e tërë.

Mosha mbizotëruese e të anketuarëve, konkretisht 69.1% e tyre është e grupmoshës 18 – 29 vjeç, 7.4 % e të anketuarëve janë të grupmoshës 26-40 vjeç, 15.9% janë të grupmoshës 41-60 vjeç dhe 7.6% mbi 60 vjeç.

Mosha




Pjesa më e madhe e të anketuarëve, konkretisht rreth 70% e tyre janë me arsim të lartë universitar dhe pasuniversitar dhe vetëm 30% kanë përfunduar arsimin e mesëm. Bazuar edhe në shpërndarjen e moshës, shumica e të anketuarëve janë studentë, 12.4% janë të punësuar në sektorin privat, 8.6% të punësuar në sektorin publik dhe 8.7% janë të papunë.

Arsimi



Punësimi



Analiza e gjetjeve kryesore

Ky pyetësor është i ndarë në disa çështje dhe synon të mbulojë një sërë tematikash për të dhënë një tablo sa më të përgjithshme mbi perceptimin e qytetarëve shqiptarë për nivelin e përhapjes së korrupsionit në sektorin publik. Qytetarët fillimisht janë pyetur mbi perceptimin e tyre mbi korrupsionin i cili mund të jetë krijuar në shumë mënyra si: bisedat me të afërm, media, etj. Më tej ata ju janë përgjigjur pyetjeve mbi përvojat e tyre personale gjatë kontaktit me institucionet shtetërore dhe marrjes së një shërbimi publik.

Në seksionin e dytë qytetarët janë pyetur mbi digjitalizimin e shërbimeve publike, përvojën dhe opinionin e tyre se si ky transformim digjital mund të ndikojë në nivelin e përhapjes së korrupsionit.

Në seksionin e tretë qytetarët kanë bërë një vlerësim me pikë mbi përhapjen e korrupsionit në disa nga sektorët dhe kanë vlerësuar zyrtarët publikë më të korruptuar sipas opinionit të tyre. Gjithashtu ata janë pyetur mbi format më të zakonshme të ushtrimit të aferave korruptive dhe shpeshësinë e ndoshjes së tyre.

Në fund të anketuarve ju është kërkuar nëpërmjet situatave hipotetike të vlerësojnë pranueshmërië e tyre ndaj disa sjelljeve korruptive dhe qëndrimet që ata do të mbanin nëse do të gjendeshin të përfshirë në këto situata. Gjithashtu ata kanë bërë një vlerësim të efikasitetit të masave të qeverisë në luftën kundër korrupsionit dhe prishtmëritë e tyre për të ardhmen. Në këtë seksion janë pyetur edhe për nivelin e besimit për një nga reformat kryesore në vend, që është reforma në sistemin gjyqësor dhe nëse kjo reformë ka filluar të japë efekte në ndëshkueshmërinë e korrupsionit të nivelit të lartë.

Perceptimi i qytetarëve për korrupsionin dhe përvoja me sjellje korruptive

Perceptimi i qytetarëve është një nga elementët më të zakonshëm që analizohen në pothuajse të gjitha anketimet mbi nivelin e pranisë të korrupsionit në Shqipëri. Ky perceptim mund të krijohet në shumë forma, duke filluar nga përvoja personale, bisedat me persona të afërmit, informacione nga mediat, mospërputhje


midis nivelit të të ardhurave të deklaruar dhe mënyrës të jetës së zyrtarëve publikë, akuzat e ndërsjellta ndërmjet kundështarëve politikë etj.

Sikurse shihet edhe në grafikun e mëposhtëm, **27.8% e të anketuarve mendojnë së të gjithë zyrtarët publikë janë të korrumpuar dhe 63.1% besojnë së shumica e zyrtarëve publikë janë të korrumpuar.** Ky perceptim është i krijuar kryesisht nga eksperiencat personale me 37.2%, bisedat me të afërmit me 28.6% dhe 23.8% e të anketuarve shprehen se kanë arritur në këtë perceptim për shkak të mospërputhjes që ata shohin midis pagave dhe mënyrës së jetesës së zyrtarëve publike dhe vetëm 8% e personave të anketuar kanë si burim të perceptimit të tyre mbi korrupsionin informacionin nga mediat.

Sipas jush, sa i përhapur është korrupsioni tek zyrtarët e administratës publike?




Vlerësimi juaj për përhapjen e korrupsionit në Shqipëri është bazuar në:




Pothuajse $\frac{3}{4}$ e qytetarëve të anketuar pohojnë se gjatë vitit të fundit janë drejtuar të paktën një herë një zyrat e një institucioni public për të marrë një shërbim dhe pothuajse gjysma e tyre pohojnë se ju është kërkuar një favor i paligjshëm nga ana e zyrtarit publik për të ofruar shërbimin në kohën dhe me cilësinë e kërkuar. 44.8% e qytetarëve pohojnë se nuk do të paguanin nëse do të kishin një mënyrë tjetër për ta zgjidhur problemin e tyre, 17.9% nuk do të paguanin në asnjë mënyrë dhe 31.6% janë të gatshëm të paguajnë apo të ofrojnë një favor tjetër të paligjshëm ndaj një zyrtari publik për të zgjidhur problemin e tyre.

A jeni drejtuar në zyrat e një institucioni publik për të marrë një shërbim gjatë vitit të fundit?



Nëse do të kishit një problem madhor dhe një zyrtar do ju kërkonte në mënyrë të drejtpërdrejtë për ta zgjidhur këtë problem, si do të vepronit?




Digjitalizimi i shërbimeve publike dhe korrupsioni


Viti 2022 i është cilësuar nga Kryeministri si viti i “Revolucionit Digjital të Shqipërisë” ky u mbyllën pothuajse të gjitha sportelet që ofronin shërbime publike për qytetarët dhe mbi 95% e këtyre shërbimeve tashmë ofrohen vetëm online. Sipas Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në Shqipëri ofrohen totalisht online mbi 1200 shërbime. Por si ka ndikuar ky “revolucion” në nivelin e përhapjes së korrupsionit në administratën publike?

Rezultatet tregojnë se **63% e të anketuarve kanë marrë të paktën një herë shërbim online gjatë vitit të fundit**, por qytetarët vijojnë të mbeten skeptikë se digjitalizimi i shërbimeve dhe mungesa e kontaktit fizik me zyrtarët publikë në sportele ka sjellë uljen e nivelit të korrupsionit. Konkretisht, **42.6% shprehën se digjitalizimi nuk ka ndikuar në uljen e nivelit të korrupsionit**, 39.8% e të anketuarve mendojnë se digjitalizimi e ka ulur nivelin e korrupsionit dhe 14% e tyre nuk kanë dhënë një përgjigje për këtë pyetje.

A keni marrë një shërbim online nga një institucion publik gjatë vitit të fundit?



A mendoni që digjitalizimi i shërbimeve ka ulur nivelin e korrupsionit në sektorin publik?




Sektorët me nivelin më të lartë të perceptimit të korrupsionit (12 -20)


Në këtë seksion të pyetësorit, qytetarëve ju është kërkuar të vlerësojnë me pikë nga 1 në 5 përhapjen e korrupsionit në disa nga sektorët kryesorë publikë, ku 1 përfaqëson përhapje shumë të ulët të korrupsionit dhe 5 përfaqëson një përhapje shumë të lartë të korrupsionit.

Sistemi gjyqësor vijon të mbetet sektori me perceptim më të lartë për korrupsion, edhe pas refomimës në drejtësi. Konkretisht 71.9% e qytetarëve mendojnë se ka një nivel shumë të lartë korrupsioni në këtë sektor. Të dytat në renditje janë **partitë politike me 71.3%**. Më tej renditen Pushteti Ekzekutiv (Kryeministri, Ministri, Institucione në varësi të ministrive) me 70%, Pushteti Lokal (Bashki, Njësi Administrative, Institucione varësie) me me 61.5%, Policia e shtetit me 60.9% dhe sistemi shëndetësor me 60.6%. Dy sektorët e perceptuar me nivel më të ulët korrupsioni nga qytetarët e anketuar janë sektori i edukimit (arsimi parauniversitar dhe univesitar) me 46.2% dhe sektori i shoqërisë civile me 41% të qytetarëve që e perceptojnë më një përhapje shumë të lartë korrupsioni. Kështu, në koherencë me këto përgjigje, në pyetjen pasardhëse se cilët perceptohen si zyrtarët publikë më të korruptuar, **kryesojnë gjyqtarët dhe prokurorët, të ndjekur nga kryetarët e bashkive, ministrat dhe deputetët.**


Si e vlerësoni përhapjen e korrupsionit në sektorin e shëndetësisë?




Si e vlerësoni përhapjen e korrupsionit në sektorin e edukimit (arsimi parauniversitar/ universitet publike)?




Si e vlerësoni përhapjen e korrupsionit në sistemin gjyqësor?




Si e vlerësoni përhapjen e korrupsionit në Policinë e Shtetit?




Si e vlerësoni përhapjen e korrupsionit në administratën e lartë të nivelit qendror (Kryeministri/Ministri/ agjensi në varësi të ministrive)?




Si e vlerësoni përhapjen e korrupsionit në administratën e pushtetit vendor (Bashki/ Njësi Administrative/ institucione varësie të pushtetit vendor)?




Si e vlerësoni përhapjen e korrupsionit tek partitë politike?



Si e vlerësoni përhapjen e korrupsionit në fushën e shoqërisë civile?




Sipas jush, cilët janë zyrtarët publikë më të korrumpuar?



Ndër format më të përhapura të korrupsionit, shumica e qytetarëve të anketuar vlerësojnë si **shumë të përhapur** secilën nga alternativat si: dhurate mjekut; dhënia e parave në këmbim të një note të mirë në provime; dhënia e parave për të marrë patentën e makinës; dhënia e parave një zyrtari të policisë që të mos ju pezullojë patentën; ndërhyrja tek një zyrtar për të punësuar dikë; ndërhyrja tek një zyrtar për të marrë leje ndërtimi; ndërhyrja për të lejuar evazionin fiskal ose për të reduktuar detyrimet tatimore.


Si e vlerësoni përhapjen e korrupsionit në sektorin e shëndetësisë?




Sjelljet dhe qëndrimet ndaj aferave korruptive (24 25 26 27)

Në anketimin e kryer, të qytetarët janë pyetur mbi përshtypjet e tyre mbi nivelin e korrupsionit dhe progresin apo regresin që ka pasur ky fenomen gjatë dekadës së fundit. Shumica dërmuese e qytetarëve prej **82.5% shprehen se gjatë 10 vjeçarit të fundit, niveli i korrupsionit ka pësuar rritje**. Po ashtu të anketuarit nuk shprehen optimistë mbi nivelin e korrupsionit në të ardhmën. Konkretisht **32.7% mendojnë se përhapja e gjerë e korrupsionit nuk do të ulet, ndërsa 49% besojnë se korrupsioni në Shqipëri do të ekzistojë gjithmonë, por mund të reduktohet pak. Vetëm 9.5% e qytetarëve shprehen optimist se në 10 vjeçarin e ardhshëm korrupsioni në Shqipëri mund të reduktohet ndjeshëm.**

Si e vlerësoni përhapjen e korrupsionit në 10 vitet e fundit?




Si mendoni që do të jetë përhapja e korrupsionit në 10 vitet e ardhshme?



Qytetarët në vijim përballen me situatë hipotetike se si do të vepronin ata në rast se do të ishin zyrtarë publikë dh dikush do ju ofronte para apo një favor tjetër në këmbim të zgjidhjes së një problem. Pothuajse ½ e qytetarëve që vendosin veten në këtë pozitë, ata nuk do e pranonin këtë veprim pasi është kundër parimeve dhe moralit të tyre. **Kështu vetëm 7% e të anketuarve i janë përgjigjur pozitivisht kësaj situatë duke pranuar të përfshihen në veprimë të tilla.**

Nëse ju do të ishit një zyrtar dhe dikush do ju ofronte para/dhuratë apo një nder në këmbim të zgjidhjes së problemit të tij/saj. Si do të vepronit në këtë rast?



- 3.3% Do të pranoja – çdonjëri do bënte këtë
- 7% Do të pranoja- nëse mund ta zgjidhja problemin e tij
- 36.3% Nuk do të pranoja, nëse zgjidhja e problemit do të përbënte shkelje ligjore
- 46.4% Nuk do të pranoja, nuk aprovoj veprime të tilla
- 7% Nuk e di/ Pa përgjigje

Një tjetër element që është synuar të matet nëpërmjet këtij pyetësi është edhe qasja denoncuese e qytetarëve kur përballen me këtë fenomen, si dëshmitarë apo si viktimë. Rezultatet dëshmojnë se **72% e qytetarëve nuk kanë denoncuar në institucionet përgjegjëse situatat korruptive kur ata kanë qënë dëshmitarë ose viktime.** Për më tepër, **59% e tyre nuk i njohin as mekanizmat apo hapat proceduralë që duhet të ndjekin për të denoncuar një situatë korruptive.**

Lidhur me pyetjen se si do të vepronin nëse do të përballeshin me një situatë korruptive në të ardhmen, rreth ½ mendojnë se do e denoncojnë këtë situatë, ndërsa gjysma tjetër nuk do e denoncojnë ose nuk janë të sigurt për hapat që do të ndërmarrin.

A mendoni se do të denonconi nëse do të bini pre e një afere korruptive në të ardhmen?



- 51.2% Po
- 14.7% Jo
- 34.1% Nuk e di/Pa përgjigje


Efikasiteti i masave anti-korrupsion

Gjatë viteve të fundit në Shqipëri janë prezntuar disa herë në publik nisma dhe masa për luftën kundër korrupsionit. Strategjia Ndërsektoriale Antikorrupsion 2015 – 2020 u ndryshua dhe ju zgjat afati deri në vitin 2023. Gjitashtu u prezantua Plan i Veprimit Kundër Korrupsionit 2020-2023. Për zbatimin e këtyre dokumenteve u ngrit Komiteti Koordinues i kryesuar nga Ministri i Drejtësisë. Një tjetër masë ishte krijimi i një Task Force Ndërinstitucionale kundër Korrupsionit, përgjegjëse për inspektimet kundër korrupsionit nëpër agjencitë qeveritare.

Por përtej këtyre masave të ndërmarra, duket se besimi i qytetarëve në efikasitetin e tyre është shumë i ulët. Rezultatet e anketimit tregojnë se **vetëm 5.4% e qytetarëve i konsiderojnë këto reforma të vlefshme, 58% e qytetarëve i konsiderojnë këto masa të pavlefshme dhe 29.2% i konsiderojnë pjesërisht të vlefshme.**

Një tjetër reformë e rëndësishme në fushën antikorrupsion është edhe reforma në sistemin e drejtësisë. Kjo reformë është miratuar 2016 ndërkohë që kanë kaluar 7 vite nga miratimi, bazuar në rezultatet e këtij pyetësi, **44,9% e qytetarëve të anketuar nuk besojnë së kjo reformë do të sjellë rezultate të prekshme në ndëshkueshmërinë e korrupsionit në nivele të larta** dhe vetëm 28.3% mendojnë së kjo reformë do të japë rezultate në të ardhmen.

A mendoni se reforma në sistemin gjyqësor do të rrisë ndëshkueshmërinë e korrupsionit në nivele të larta?




Gjetjet Kryesore

- 27.8% e të anketuarve mendojnë së të gjithë zyrtarët publikë janë të korruptuar dhe 63.1% besojnë së shumica e zyrtarëve publikë janë të korruptuar.
- Pothuajse $\frac{3}{4}$ e qytetarëve të anketuar pohojnë se gjatë vitit të fundit janë drejtuar të paktën një herë një zyrat e një institucioni publik për të marrë një shërbim dhe pothuajse gjysma e tyre pohojnë se ju është kërkuar një favor i paligjshëm nga ana e zyrtarit publik për të ofruar shërbimin në kohën dhe me cilësinë e kërkuar.
- 31.6% e qytetarëve të anketuar janë të gatshëm të paguajnë apo të ofrojnë një favor tjetër të paligjshëm ndaj një zyrtari publik për të zgjidhur problemin e tyre.
- 63% e të anketuarve kanë marrë të paktën një herë shërbim online gjatë vitit të fundit, por 42.6% shprehen se digjitalizimi nuk ka ndikuar në uljen e nivelit të korrupsionit.
- Sistemi gjyqësor vijon të mbetet sektori me perceptim më të lartë për korrupsion, edhe pas refomimës në drejtësi, ku 71.9% e qytetarëve mendojnë së ka një nivel shumë të lartë korrupsioni në këtë sektor.
- Sipas qytetarëve të anketuar, zyrtarët publikë më të korruptuar janë gjyqtarët dhe prokurorët, të ndjekur nga kryetarët e bashkive, ministrat dhe deputetët.
- 82.5% e qytetarëve shprehen se gjatë 10 vjeçarit të fundit, niveli i korrupsionit ka pësuar rritje. 32.7% mendojnë se përhapja e gjerë e korrupsionit nuk do të ulet, ndërsa 49% besojnë se korrupsioni në Shqipëri do të ekzistojë gjithmonë, por mund të reduktohet pak. Vetëm 9.5% e qytetarëve shprehen optimist së në 10 vjeçarin e ardhshëm korrupsioni në Shqipëri mund të reduktohet ndjeshëm.
- Rezultatet dëshmojnë se 72% e qytetarëve nuk kanë denoncuar në institucionet përgjegjëse situatat korruptive kur ata kanë qënë dëshmitarë ose viktime dhe 59% e tyre nuk i njohin as mekanizmat apo hapat procedurialë që duhet të ndjekin për të denoncuar një situatë korruptive.
- Vetëm 5.4% e qytetarëve i konsiderojnë masat dhe reformat në fushën e antikorrupsionit të vlefshme, 58% e qytetarëve i konsiderojnë këto masa të pavlefshme dhe 29.2% i konsiderojnë pjesërisht të vlefshme.
- 44,9% e qytetarëve të anketuar nuk besojnë së reforma në drejtësi do të sjellë rezultate të prekshme në ndëshkueshmërinë e korrupsionit në nivele të larta.

Rekomandime

- Sikurse dëshmojnë edhe rezultatet e mësipërme të anketimit, korrupsioni në shoqërinë shqiptare është i shtrirë në mënyrë kapilare dhe vetëm reformimi i sistemit të drejtësisë nuk mjafton për të arritur rezultate të qëndrueshme në luftën kundër korrupsionit. Në stadin aktual të shpërndarjes së korrupsionit në vend, rekomandohet një reformim i thellë i Administratës Publike.
- Institucionet e reja të dala nga reforma në drejtësi duhet të përshpejtojnë punën e tyre për të ndëshkuar zyrtarë të niveleve të larta të cilët janë të përfshirë në afëra korruptive apo ushtrim të ndikimit tek zyrtarët në varësi të tyre për përfshirje në korrupsion. Vetëm rezultate konkrete nga këto institucione mund të kthejnë besueshmërinë e rreth 45% e qytetarëve që nuk besojnë tek këto institucione.
- Për luftimin me sukses të kulturës së rrënjosur të korrupsionit si fenomen shoqëror, kërkohet rritja e ndërgjegjësimit publik dhe edukimit të qytetarëve. Vrojtimi tregon se 59% e tyre nuk i njohin mekanizmat apo hapat proceduralë që duhet të ndjekin për të denoncuar një situatë korruptive, prandaj rekomandohet edukimi në moshë të hershme kundër korrupsionit dhe fokusi i reformave tek qasja parandaluese paralelisht me qasjen ndëshkuese.
- Luftimi i korrupsionit nuk mund të bëhet vetëm nga një institucion apo person i vetëm. Prandaj nevojitet një bashkëpunim gjithëpërfshirës midis strukturave të ndryshme institucionale ndërmjet strukturave qeveritare dhe atyre joqeveritare. Në këtë proces duhet të ketë një përfshirje më të gjerë dhe një rol më aktiv të shoqërisë civile.



RAPORT MONITORIMI

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD